

## Shënime Sqaruese

# Zbatimi i ligjit të Amnistisë Fiskale 2011 (Nr.10418/21.04.2011)

**Afati i vlefshëm i aplikimit:** Nga 18 Maj 2011 deri 31 Dhjetor 2011

## Objekt i ligjit

- Legalizimi i parave dhe aktiveve afatgjata (AAM) dhe afatshkurtra (AAF) materiale pas kryerjes së pagesës së detyrimeve, sipas parashikimeve në këtë ligj, duke u konsideruar si të ardhura apo AAM dhe AAF, për të cilat detyrimet tatimore janë paguar në përputhje me legjislacionin shqiptar (neni 13);
- falja e një pjese të borxhit tatimor e doganor, kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore (neni 1);
- mosfillimi apo ndërprerja ndaj subjekteve, të procedurave administrative (neni 2,4 dhe 11);
- mosnxjerrja e vendimeve të kundërvajtjeve administrative të lidhura me fshehjen e të ardhurave dhe/apo mospagimin e taksave dhe të tatimeve ndaj subjekteve (neni 2,4 dhe 11);
- pushimi i veprimeve procedurale të mbetura, të parashikuara në legjislacionin tatimor, doganor, si dhe atë të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore e që lidhen me mbledhjen me forcë të këtyre detyrimeve (neni 2,4 dhe 11).
- Falja e detyrimeve të tjera për energjinë elektrike, ujin, automjetet dhe kundrvajtje administrative sipas legjislacionit fiskal e të lidhur me të.

## Përfituesit nga ligji

### 1. Për legalizim

- a) *individë apo përfaqësues të tyre;*
- b) *shtetas të Republikës së Shqipërisë apo përfaqësues të tyre;*
- c) *persona fizikë të regjistruar si të tillë në organet përkatëse apo përfaqësues të tyre;*
- d) *persona juridikë apo përfaqësues të tyre.*

### 2. Për falje detyrimesh fiskale

- a) *tatimpaguesit (sipas nenit 5, germa g) e Ligjit "Për procedurat tatimore në RSH"), që nuk kanë bërë kërkesa në administratën tatimore për kthim tatimesh paguar tepër, si dhe kur nuk kanë situatë kreditore ndaj administratës tatimore (neni 18);*
- b) *tatimpaguesit (sipas nenit 5, germa g) e Ligjit "Për procedurat tatimore në RSH"), që kanë bërë kërkesa në administratën tatimore për kthim tatimesh paguar tepër, si dhe kur kanë situatë kreditore ndaj administratës tatimore, që pranojnë, me shkrim, që shuma për tu rimbursuar apo për tu kredituar nga administrata tatimore të zvogëlohet në vlerë të barabartë me shumën e detyrimit tatimor të falur (neni 18);*
- c) *individët, shtetasit, personat fizikë tregtarë, personat juridikë që janë debitorë ndaj administratës doganore (neni 18);*
- d) *tatimpaguesit e vetëpunësuar (dhe në sektorin bujqësor) (neni 23).*

### 3. Për falje detyrime të tjera

- a) *debitorët familjarë ndaj K.E.SH sh.a, (a) kryefamiljarët e familjeve që përfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike; (b) familjet që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuara, të verbër, paraplegjikë ose tetraplegjikë, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të komisioneve mjekësore të posaçme dhe që përfitojnë pagesë aftësie të kufizuar, kur personi është kryefamiljar dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik a privat ose të vetëpunësuar në sektorin privat; (c) kryefamiljarët që përfitojnë pagesë papunësie dhe që nuk kanë të ardhura të tjera; (ç) kryefamiljarët që*

- përfitojnë pension pleqërie dhe jetojnë të vetëm ose kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura dhe janë të papunë; (d) kryefamiljarët që përfitojnë pension, për të gjitha kategoritë, si dhe përfituesit me trajtim të veçantë, që kanë masë përfitimi më të vogël se të ardhurat minimale që përfitojnë pensionistët, të cilët janë pa të ardhura të tjera; (dh) kryefamiljarët që përfitojnë pension invaliditeti dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik a privat ose nuk janë të vetëpunësuar; (e) gratë kryefamiljare; (ë) të gjithë personat kryefamiljarë që gëzojnë statusin e jetimit. Faljen e përfitojnë gjithë kategoritë që këtë status e zotërojnë në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji (neni 29);
- b) debitorët e kategorive “konsumatorë familjarë” dhe “jofamiljarë” ndaj Ndërmarrjeve dhe Shoqërive me kapital tërësisht shtetëror të Ujësjellës-Kanalizimeve (*deri në datën e bërjes efektive të transferimit të shoqërive pranë njërive të qeverisjes vendore*) (neni 30);
- c) pronarët e mjeteve, debitorë ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (neni 31)

**Legalizim i kapitalit** konsiston në kushtin e:

- *deklarimit vullnetar* (neni 8), që bëhet me formularë aplikimi të miratuar nga administrata nga (a) individë; (b) shtetas të Republikës së Shqipërisë; (c) persona fizikë të regjistruar si të tillë në organet përkatëse, (d) përfaqësues të kategorive (a), (b) dhe (c); për paratë që zotërojnë, brenda ose jashtë vendit, si dhe pagimin e tarifës në institucionet përkatëse për depozitimin e kësaj shume në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri (neni 3);

- *deklarimit vullnetar* (neni 8), që bëhet me formularë aplikimi të miratuar nga administrata nga persona juridikë, me seli në Republikën e Shqipërisë, të cilët janë të regjistruar në regjistrin kombëtar të tatimpaguesve, të diferencës pozitive që rezulton nga rivlerësimi i pasurisë, sipas orientimit të ligjit të aministisë, si dhe pagimin e tarifës në institucionet përkatëse për këtë rivlerësim (neni 3).

## Periudhat dhe kushtet për zbatimin e ligjit

### 1. Legalizimi

Për individët (*person fizik jotregtar sipas Kodit Civil*):

- paratë që kanë të padeklaruar në administratën tatimore (*nëse është objekt i nenit 7 të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat"*), apo të padepozituara në institucione financiare bankare deri në muajin që aplikohet në bankë (neni 5 dhe 9)

Për shtetasit (*person fizik jotregtar sipas Kodit Civil*):

- paratë që kanë të padeklaruar në administratën tatimore (*nëse është objekt i nenit 7 të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat"*), apo të padepozituara në institucione financiare bankare deri në muajin që aplikohet në bankë (neni 5 dhe 9)

Për personat fizikë tregtar, (*sipas ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"*): :

- paratë që kanë të padeklaruar në administratën tatimore apo të padepozituara në institucione financiare bankare deri në muajin që aplikohet në bankë (neni 5 dhe 10)

Për personat juridikë, (*sipas ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"*):

- aktive të padeklaruar në pasqyrat financiare apo regjistrime kontabile të aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale me vlerë më të ulët se vlera e tregut përpara muajit që aplikohet për legalizim në drejtorinë rajonale tatimore (neni 5 dhe 11)

## **2. Falja (fiskale dhe Detyrimet e tjera)**

Për individët (*person fizik jotregtar sipas Kodit Civil*):

- të gjitha detyrimet tatimore të papaguara deri më 31 dhjetor 2010 (neni 19,b);
- detyrimet, gjobat dhe kamatëvonesat ndaj administratës doganore, të lindura deri më 31 dhjetor 2008, të evidentuara e të kontabilizuara deri më 31 dhjetor 2010 dhe të papaguara (neni 26,1);
- gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara, të lidhura me detyrimet e lindura gjatë vitit 2009, të evidentuara e të kontabilizuar deri në hyrjen në fuqi të ligjit dhe të papaguara nëse paguajnë 50 për qind të shumës së principalit të detyrimit (neni 26,2);
- gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara, të lidhura me detyrimet e lindura gjatë vitit 2010, të evidentuara e të kontabilizuar deri në hyrjen në fuqi të ligjit dhe të papaguara nëse paguajnë 100 për qind të shumës së principalit të detyrimit (neni 26,3);
- 50 për qind të principalit të detyrimit, së bashku me gjobat dhe kamatëvonesat, për automjete, të cilët janë futur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë deri në fund të vitit 2010 (neni 26,4);
- të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që, brenda kohës së zbatimit të këtij ligji, të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut duke paguar tatimin 1 % të (a) diferencës ndërmjet çmimit të kontratës së regjistruar në këtë zyrë dhe vlerës së pasqyruar në akt ekspertim (neni 27,4); (b) diferencës ndërmjet çmimit të kontratës së regjistruar në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale (neni 27,6); (c) vlerës së çmimeve minimale fiskale në çastin e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (neni 27,8);

Për shtetasit (*person fizik jotregtar sipas Kodit Civil*):

- të gjitha detyrimet tatimore të papaguara deri më 31 dhjetor 2010 (neni 19,b);
- detyrimet, gjobat dhe kamatëvonesat ndaj administratës doganore, të lindura deri më 31 dhjetor 2008, të evidentuara e të kontabilizuara deri më 31 dhjetor 2010 dhe të papaguara (neni 26,1);

- gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara, të lidhura me detyrimet e lindura gjatë vitit 2009, të evidentuara e të kontabilizuar deri në hyrjen në fuqi të ligjit dhe të papaguara nëse paguajnë 50 për qind të shumës së principalit të detyrimit (neni 26,2);
- gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara, të lidhura me detyrimet e lindura gjatë vitit 2010, të evidentuara e të kontabilizuar deri në hyrjen në fuqi të ligjit dhe të papaguara nëse paguajnë 100 për qind të shumës së principalit të detyrimit (neni 26,3);
- 50 për qind të principalit të detyrimit, së bashku me gjobat dhe kamatëvonesat, për automjete, të cilët janë futur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë deri në fund të vitit 2010 (neni 26,4);
- të gjithë shtetasit, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që, brenda kohës së zbatimit të këtij ligji, të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut duke paguar tatimin 1 % të (a) diferencës ndërmjet çmimit të kontratës së regjistruar në këtë zyrë dhe vlerës së pasqyruar në akt ekspertim (neni 27,4); (b) diferencës ndërmjet çmimit të kontratës së regjistruar në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale (neni 27,6); (c) vlerës së çmimeve minimale fiskale në çastin e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (neni 27,8);

## Për të vetëpunësuarit *(dhe në sektorin bujqësor)*

- të gjitha detyrimet e papaguara të lidhura të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për veten e tyre, deri në fund të vitit 2008 *(nëse paguajnë të gjitha shumat e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, brenda 2011, ata përfitojnë nga falja e të gjitha gjobave dhe kamatëvonesave të lidhura me detyrimet e pashlyera)* (neni 23,1.a, 2);
- të gjitha detyrimet e papaguara të lidhura të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për veten e tyre për periudhën nga 1 janari 2009 deri më 31 dhjetor 2010, me kusht që brenda datës 31 dhjetor 2011, të deklarojnë dhe të paguajnë të gjitha detyrimet që lindin gjatë vitit 2011 *(nëse paguajnë të gjitha shumat e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, brenda 2011, ata përfitojnë nga falja e të gjitha gjobave dhe kamatëvonesave të lidhura me detyrimet e pashlyera)* (neni 23,1.b, 2);

Për personat fizikë tregtar, (të regjistruarit si subjekt i taksës vendore të biznesit të vogël):

- të gjitha detyrimet tatimore, të papaguara deri më 31 dhjetor 2010 (neni 19,a)
- të gjitha gjobat e papaguara për mosplotësimin në kohë të detyrimit për t'u pajisur me pajisje fiskale (*për mosinstalim të pajisjeve fiskale*), kur e kanë instaluar pajisjen fiskale brenda datës 28 shkurt 2011 (neni 22);
- 50% e diferencës midis detyrimeve tatimore të çdo tipi, sipas transaksioneve reale të tyre, me detyrimet tatimore të deklaruara, (*përfshirë kamatëvonesat dhe gjobat, që do të aplikoheshin në këto raste*) përpara se ndaj tyre të ketë filluar një kontroll tatimor i administratës tatimore (*nëse nga kontrolli tatimor rezulton se detyrimi tatimor është më i madh se ai i vetëdeklaruar nuk zbatohet kjo pikë*) (neni 22);
- të gjitha shumat e gjobave dhe të kamatëvonesave për të gjitha detyrimet e papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore deri më 31 dhjetor 2010 (neni 24);
- detyrimet, gjobat dhe kamatëvonesat ndaj administratës doganore, të lindura deri më 31 dhjetor 2008, të evidentuara e të kontabilizuara deri më 31 dhjetor 2010 dhe të papaguara (neni 26,1);
- gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara, të lidhura me detyrimet e lindura gjatë vitit 2009, të evidentuara e të kontabilizuar deri në hyrjen në fuqi të ligjit dhe të papaguara nëse paguajnë 50 për qind të shumës së principalit të detyrimit (neni 26,2);
- gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara, të lidhura me detyrimet e lindura gjatë vitit 2010, të evidentuara e të kontabilizuar deri në hyrjen në fuqi të ligjit dhe të papaguara nëse paguajnë 100 për qind të shumës së principalit të detyrimit (neni 26,3);
- 50 për qind të principalit të detyrimit, së bashku me gjobat dhe kamatëvonesat, për automjete, të cilët janë futur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë deri në fund të vitit 2010 (neni 26,4);
- detyrimet e papaguara të tilla si: mospagesat për arka regjistruese, certifikata tatimore, shtypshkrime, fatura tatimore, pullë akcize apo bileta transporti (neni 32);

Për personat juridikë, (sipas ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"):

- detyrimet tatimore të papaguara (përfshire edhe personat fizikë, të regjistruar si subjekt i TVSH-së), që janë evidentuar në regjistrat e administratave tatimore deri në datën 31 dhjetor 2008 (neni 19,c);
- detyrimet tatimore të papaguara (përfshire edhe personat fizikë, të regjistruar si subjekt i TVSH-së), që janë evidentuar në regjistrat e administratave tatimore për vitin fiskal 2009, nëse paguhet **30%** e detyrimit (përfshire dhe kamatëvonesat) (neni 20,1);
- detyrimet tatimore të papaguara (përfshire edhe personat fizikë, të regjistruar si subjekt i TVSH-së), që janë evidentuar në regjistrat e administratave tatimore për vitin fiskal 2010, nëse paguhet **50%** e detyrimit (përfshire dhe kamatëvonesat) (neni 20,2);
- të gjitha shumat e gjobave dhe të kamatëvonesave për të gjitha detyrimet e papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore deri më 31 dhjetor 2010 (neni 24);
- detyrimet, gjobat dhe kamatëvonesat ndaj administratës doganore, të lindura deri më 31 dhjetor 2008, të evidentuara e të kontabilizuara deri më 31 dhjetor 2010 dhe të papaguara (neni 26,1);
- gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara, të lidhura me detyrimet e lindura gjatë vitit 2009, të evidentuara e të kontabilizuar deri në hyrjen në fuqi të ligjit dhe të papaguara nëse paguajnë 50 për qind të shumës së principalit të detyrimit (neni 26,2);
- gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara, të lidhura me detyrimet e lindura gjatë vitit 2010, të evidentuara e të kontabilizuar deri në hyrjen në fuqi të ligjit dhe të papaguara nëse paguajnë 100 për qind të shumës së principalit të detyrimit (neni 26,3);
- 50 për qind të principalit të detyrimit, së bashku me gjobat dhe kamatëvonesat, për automjete, të cilët janë futur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë deri në fund të vitit 2010 (neni 26,4);
- detyrimet e papaguara të tilla si: mospagesat për arka regjistruese, certifikata tatimore, shtypshkrime, fatura tatimore, pullë akcize apo bileta transporti (neni 32);



## Për pronarët e mjeteve

- detyrimet e prapambetura për taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve dhe taksën vjetore të qarkullimit rrugor deri më 31 dhjetor 2010 *(përfshirë dhe detyrimet për këto taksa, për të gjitha mjetet e dala jashtë qarkullimit, por të paçregjistruara deri në datën 31 dhjetor 2010)* (neni 19, ç);
- detyrimet, gjobat dhe kamatëvonesat ndaj administratës doganore, të lindura deri më 31 dhjetor 2008, të evidentuara e të kontabilizuara deri më 31 dhjetor 2010 dhe të papaguara (neni 26,1);
- gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara, të lidhura me detyrimet e lindura gjatë vitit 2009, të evidentuara e të kontabilizuar deri në hyrjen në fuqi të ligjit dhe të papaguara nëse paguajnë 50 për qind të shumës së principalit të detyrimit (neni 26,2);
- 50 për qind të principalit të detyrimit, së bashku me gjobat dhe kamatëvonesat, për automjete, të cilët janë futur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë deri në fund të vitit 2010 (neni 26,4);

## Për debitorët familjarë

- detyrimet e prapambetura për energjinë elektrike, të faturuar dhe të papaguar deri më 31 dhjetor 2006, ndaj K.E.SH sh.a, përfshirë kamatëvonesat e përllogaritura nga mospagesa e faturave (neni 29);

## Për debitorët e kategorive “konsumatorë familjarë” dhe “jofamiljarë”

- detyrimi, së bashku me gjobat dhe kamatëvonesat e konsumit të ujit, që kanë ndaj Ndërmarrjeve të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Shoqërive me kapital tërësisht shtetëror, deri në datën e bërjes efektive të transferimit të shoqërive pranë njësive të qeverisjes vendore, por jo më vonë se data 31 dhjetor 2010 (neni 30).

## Për pronarët e mjeteve

- Gjobat dhe kamatëvonesat ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, të cilat janë vendosur nga inspektorët e kontrollit rrugor deri në datën 31 dhjetor 2010 (neni 31)